



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 154 dhe 156 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 155 dhe 157 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 50,000.00 €, (pesëdhjetë mijë euro) për mbështetje financiare për familjen e Rreshterit Afrim Bunjaku të renë në detyrë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201 në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi në llogarinë bankare të caktuar nga familja Rreshterit Afrim Bunjaku.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Administrimin e Procedurave Tatimore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/162
Datë: 27.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Shtetëror për shënimin e 26 vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 25 vjetorit të Çlirimit të Kosovës dhe 16 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Znj. Donika Gërvalla - Schwarz, Zëvendëskryeministre e dytë, dhe Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare;
 - 1.3. Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.4. Z. Ejup Maqedonci, Ministër i Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.5. Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë, anëtare;
 - 1.6. Z. Xhelal Sveçla, Ministër i Punëve të Brendshme;
 - 1.7. Z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.8. Z. Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar.
2. Ftohen ta dërgojnë nga një përfaqësues:
 - 2.1. Zyra e Presidentes;
 - 2.2. Kuvendi i Kosovës;
 - 2.3. Komuna e Prishtinës;
 - 2.4. Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së;
 - 2.5. Organizatat e Shoqërisë Civile.
3. Këshilli mund të themeloj Grupet e Punës relevante për arritën e objektivat e këtij Këshilli.
4. Obligohet Këshilli Shtetëror dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafit 7, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Kriteret dhe Procedurat e Emërimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ratifikimi i 3 (tre) anëtarëve vendorë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si në vijim:
 - 1.1. Mirlinda Batalli;
 - 1.2. Avni Berisha;
 - 1.3. Jetmir Haxhibeqiri.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me biografitë e të propozuarve nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia dërgoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13.12.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 03/128 të datës 16.02.2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000,000.00 €, (pesë milionë euro) për zbatimin e masës 4. të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00097) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15, paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë në shumë prej 6,000,000.00 € (gjashtë milionë euro) për Projektin "Ndërtimi i rrugës Prishtinë-Podujevë.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Kontigjencat në Ministria e Financave" me Kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve, "Shpenzime kapitale" nga Projekti "Projekti kapital/Kontgjencia në MF", kodi 18546, dhe transferohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, në nën-programin "Ndërtimet e reja të Rrugëve" me kod 42100, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" në Projektin "Ndërtimi i rrugës Prishtinë - Podujevë me kod 14540.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Dritares së Vetme Kombëtare për Kosovën.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 8/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 1,123,675.77 € (një milion e njëqindnjëzetetë mijë e gjashtëqindeshtatëdhjetepesë euro e shtatëdhjeteshtatë cent) nga nën-programi "Dëme natyrore në bujqësi" me kod 47600, Kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në Kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kod 203, për kompensimin e dëmeve natyrore në bujqësi në komunat si vijon: Deçan, Gjakovë, Graçanicë, Junik, Kamenicë, Malishevë, Prishtinë, Vushtrri, Gjilan, Lipjan, Novobërdë, Skenderaj, Rahovec dhe Podujevë.
2. Me mjetet e ndara financiare nga pika 1. e këtij Vendimi, ju kompensohen dëmet fermerëve të komunave përkatëse, të evidentuar sipas Raportit plotësues të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi për vitin 2022, në shumën e dëmeve prej 82% për secilin fermer.
3. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/162
Datë: 27.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Kodit 50400 të paraparë në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për rindërtimin dhe renovimin e shtëpive individuale për familjet të cilave u janë dëmtuar shtëpitë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera gjatë periudhës kohore 1998-1999.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që përmes Kodit 50400 të paraparë në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 të realizoj Projektin "Ndërtimi i shtëpive në Veri të Republikës së Kosovës".
3. Familjet përfituese në këtë Projekt të rindërtimit dhe renovimit të shtëpive individuale do të jenë familjet, të cilave sipas vlerësimit nga Komisioni Komunal Vlerësues, ju kanë dëmtuar shtëpitë e tyre nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera gjatë periudhës kohore 1998-99.
4. Të gjitha familjet përfituese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas rindërtimit dhe renovimit do të ri-fillojnë për të banuar në këto shtëpi dhe nuk e kanë të drejtën e shitjes apo tjetërsimit të këtyre shtëpive apo të pronës ndërtimore ku gjenden këto shtëpi në periudhë kohore prej 10 (dhjetë) viteve.
5. Qeveria e autorizon Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që në bashkëpunim me organin kompetent komunal dhe me kryefamiljaret përfitues të fillojnë procedurat dhe procesin për ri-ndërtimin e shtëpive individuale për këta banorë përfitues nga ky Projekt.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/162
Datë: 27.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i Kompleksit Sportiv "Qendra Nacionale e Xhudos" Zona Kadastrale Pejë, Komuna e Pejës, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është raporti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Obligohet Subjekti Kërkues/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të transferojë në Kodin e Shpronësimit mjetet financiare për pagesën e pronave të shpronësuara dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit.
8. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga mjetet financiare të pranuar nga Subjekti Kërkues sipas pikës 7. të këtij Vendimi, do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportin e vlerësimit komfor legjisacionit në fuqi.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/162
Datë: 27.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Komunës së Dragashit për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh O.B "Sharri prodhimi" parcela kadastrale Nr.1048-3 dhe Objektivin që menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Zonës së Gjellër-Parkut Publik për nevoja të Komunitetit" Zona Kadastrale: Bresanë, Komuna Dragash, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Komunës së Dragashit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Dragashit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr. 4 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2014".
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës dhe KfW, Frankfurt Am Main për Projektin “ Programi i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta II-IV (Kontributi i BE-së)”.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komunës së Prishtinës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Korniza e Qyteteve të Gjelbra 2. Dritarja 2. - Eficienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prishtinë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/162
Datë: 27.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore, Konservimi dhe Investimi në "Lokalitetin Arkeologjik të Dresnikut", pjesë e trashëgimisë në mbrojtje të përhershme (nr. unik TKRKS2A005, Zona Kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuara dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 04/128 të datës 16.02.2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 6. e Vendimit të Qeverisë Nr.04/128, të datës 16 shkurt 2023 si në vijim:
 - 1.1. Obligohen të gjitha institucionet që deri me 31 dhjetor 2023 të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës në institucionet e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-111, dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi Mbikëqyrës i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh. A. (tutje "Ndërmarrja").
2. Emërohet Bordi Mbikëqyrës i Përkohshëm i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh. A. në këtë përbërje:
 - 2.1. Znj. Rrezarta Pllana, kryesuese;
 - 2.2. Z. Alban Krasniqi, anëtar;
 - 2.3. Znj. Merita Beqiri-Gashi, anëtare;
 - 2.4. Z. Dragiša Krstović, anëtar.
3. Mandati i bordit mbikëqyrës të përkohshëm nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë (6) muaj dhe nuk mund të vazhdohet.
4. Anëtari i pestë i Bordit Mbikëqyrës të përkohshëm do të emërohet pasi të propozohet nga aksionarët në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/58 i datës 2 shkurt 2022 për emërimin e Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Neni 19 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (LNP), i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-111, përcakton:

1. Kurdo që ka informata të besueshme se Bordi i Drejtorëve ose një drejtor individual i NP-së ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre fiduciare, Aksionari(ët) do të zhvillojnë një hetim të hollësishëm dhe pa vonesë.

2. Nëse Aksionari(ët) përmes Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve konstatojnë se shkelja në fakt ka ndodhur, Aksionari(ët) (i) pas rekomandimit të Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve menjëherë do ta shkarkojë dhe zëvendësojë drejtorin ose drejtorët përgjegjës dhe (ii) NP menjëherë duhet të kërkojë masa ligjore kundër drejtorëve të cilët kanë bërë shkeljen kurdo që provat në dispozicion me arsye supozohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e suksesshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja; megjithatë, NP nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër drejtorit(ëve) të cilët kanë bërë shkeljen nëse me arsye ka gjasa se shumica e kompensimit e cila mund të fitohet do të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.
3. Nëse Aksionari(ët) kanë arsye për të besuar se ka mundësi që një drejtor të ketë bërë shkeljen e detyrave fiduciare, ata menjëherë do ta shkarkojnë dhe zëvendësojnë drejtorin ose drejtorët të cilët me arsye besohet se kanë bërë shkeljen e detyrave të tyre fiduciare, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që mund të paraqesë për NP-në ngritja e një padie nga ana e drejtorit/ëve të shkarkuar.

Tutje, neni 9.7 i Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën përcakton: "Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga aksionarët që përfaqësojnë, sipas dispozitave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës.

"Bordi mbikëqyrës i Ndërmarrjes është emëruar me vendim të Qeverisë më 2 shkurt 2022.

Më 20 shtator 2023, kanë dhënë dorëheqje dy anëtarë të bordit mbikëqyrës: msc. Bujar Bilalli dhe msc. Muharrem Peci.


Në kuadër të funksionit të vet monitorues, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP) ka gjetur se bordi mbikëqyrës përkatësisht komisioni i auditimit i Ndërmarrjes kanë kryer këto veprime ose mosveprime:

- Nuk ka miratuar strategji zhvillimore të Ndërmarrjes.
- Nuk ka miratuar rregullore për kompensimin e punëtorëve në përputhje me realizimin e planit të prodhimit dhe të të hyrave, çka nevojitet për të nxitur punëtorët me shpërblime për tejkalimin e planit dhe për të shmangur detyrimet e papërbalueshme për pagat në rastet kur mosrealizimi i planit të prodhimit nuk siguron të hyrat e nevojshme.
- Ka vendosur të shpallë konkurs për punësimin e xehetarëve pa kërkesë paraprake të menaxhmentit dhe përkundër mosrealizimit të të hyrave sipas planit të biznesit, duke rënduar likuiditetin e Ndërmarrjes në kohën kur Ndërmarrja has në vështirësi për të paguar punëtorët me kohë.
- Nuk ka siguruar auditimin e keqmenaxhimit të Ndërmarrjes ndër vite, që ka çuar në borxhe të grumbulluara prej dhjetëra miliona eurosh, strukturë të paqëndrueshme organizative, kontrata të pavolitshme për shitjen e koncentratit ose objekte të tjera, si dhe uzurpimin e pronës së Ndërmarrjes. Auditimi i mirëfilltë do të zbulonte mundësitë për të përmirësuar gjendjen e Ndërmarrjes ose për të hetuar përgjegjësinë e personave vendimmarrës.

NjPMNP ka konstatuar se bordi mbikëqyrës i Ndërmarrjes ka shkelur detyrat fiduciare, dhe i ka rekomanduar Qeverisë si aksionare të shkarkojë anëtarët e bordit mbikëqyrës. Mbështetur në konstatimin dhe rekomandimin nga NjPMNP dhe në përputhje me nenin 19 të LNP-së, Qeveria shkarkoi bordin mbikëqyrës si në dispozitiv.

Neni 43 i LNP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-111, detyron Qeverinë të emërojë një bord të përkohshëm pas shkarkimit të bordit paraprak. Bordi i përkohshëm shërben deri në emërimin e bordit me mandat të rregullt, por jo më gjatë se 6 muaj. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 43 të LNP-së lidhur me nenin 9 të Ligjit për Trepçën, Qeveria emëroi bordin mbikëqyrës të përkohshëm si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/162
Datë: 27.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25. paragrafi 1. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/1-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,379,372.00 € (një milion e treqindeshtatëdhjetenëntë mijë e treqindeshtatëdhjetedy euro), për ndarjen e mjeteve shtesë për Projektin "Projekti Emergjent Covid-19 për Kosovën" nga fondi i huamarrjes klauzola e investimeve 06.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nën-programi "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT" me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" nga Projekti "Kontigjenca për Klauzola te investimeve" kod 15045. nga fondi i huamarrjes klauzola e investimeve 06, dhe transferohen në Ministrinë e Shëndetësisë, me kod 206, në nën-programin "Administrata Qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë" me kod 11306, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale" në Projektin "Projekti Emergjent Covid-19 për Kosovë" me kod 15880, nga fondi i huamarrjes klauzola e investimeve 06.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë